



AKT - THEMELIMI
PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ A. E. DISTRIBUTION “ sh.p.k.

Ne baze te ligjit nr 7638 dt. 19.11.1992 “ Per shoqerit tregtare” dhe te ligjit nr 7667 dt. 28.01.1993 “ Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar nga shoqerite tregtare, une
Gerian KUKA I biri Reshatit, lindur ne Tirane me dt. 23.03.1974, banuse ne Tirane ne Rr. Tefta Tashko Pall. Nr 132 Shk. 1 Ap. 8 me cilesine e ortakut te vetem nxjer kete Akt – Themelimi me kushtet si me poshte :

NENI 1

Themelohet shoqeria tregtare me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin ‘ A. E. DISTRUBUTION” sh.p.k.

NENI 2

Shoqeria “ A. E. DISTRUBUTION “ sh.p.k. themelohet nga ortaku I vetem Gerian KUKA.

NENI 3

Shoqeria ka selin e saj ne Tirane ne Rrugen Jordan Misja ish UMB. Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te ortakut te vetem.

NENI 4

Shoqeria eshte persone juridike shqipetar. Ne veprimtarin e saj ajo zbaton legjistacionin ne fuqi, normat e aktit te themelimit e te statutit.

NENI 5

Shoqeria themelohet per te vepruar me nje periudhe kohe te pa kufizuar. Ajo e shtin veprimtarine e saj ne gjithe teritorin e vendit.

NENI 6

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte :

“Import – eksport te te gjitha llojeve te mallrave, tregtimin me shumic e pakice te mallrave ushqimore,elektronike, veshje, mobilje etj, menaxhimin e bare-restoranteve, hoteleve, serviseve

NENI

7

Kapitali Themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke , zoterohet teresisht nga ortaku I vetem Gerian KUKA.

NENI

8

Kapitali themeltar eshte I ndare ne 100 pjese te barabarta secila me vlere nominale 1000 leke

NENI

9

Kapitali themeltar eshte I shprehur teresishte ne para dhe I likujduhar plotesisht ne banke

NENI

10

Rritja e kapitalit themeltar te shoqerise behet sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare dhe percaktuar ne statutin e shoqerise.

NENI

11

Veprimtaria e shoqerise pasqyrohet ne Bilancet Financiare. Ortaku I vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar. Fitimi I realizuar nga veprimtaria e shoqerise , pas shlyerjes se gjithë detyrimeve I takon ortakut te vetem te shoqerise.

NENI

12

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

NENI

13

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Ortaku pasi e lexoj me vemendje kontraten e mesiperme dhe e gjene ate konforem vullnetit tij, firmos rregullisht.

Tirane me 5. 4. 2002

ORTAKU I VETEM

GERIAN KUKA

Gerian Kuka
[Signature]

S T A T U T I
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ A. E. DISTRIBUTION “ sh.p.k.

Ne baze te ligjit nr 7638 dt. 19.11.1992 “Per shoqerit tregtare“, te ligjit nr 7667 dt. 28.01.1993 “Per regjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar nga shoqerite tregtare”, ne zbatim te dispozitave te aktit te themelimit, ortaket nxjerrin kete statut per veprimtarise e shoqerise tregtare “A.E. DISTRIBUTION” sh.p.k.

K R E U I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Eshte themeluar shoqeria tergetare me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “A.E.DISTRIBUTION” sh.p.k..
Kjo shoqeri eshte themeluar nga ortaku :

GERIAN KUKA

NENI 2

Shoqeria ka selin e saj ne Rrugen Jordan Misja (ish U M B Tirana) Tirane Albania .

Shoqeria “A.E. DISTRIBUTION” sh.p.k. ka te drejte te cele filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te shqiperise dhe jashte saj, ne perputhje me legjistacionin shqiptar dhe ate te vendeve te tjera ku ato do te hapen.

NENI 3

Shoqeria “A.E.DISTRIBUTION” sh.p.k. e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjistacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne ne dokumentat e krijimit te saj (Aktit te themelimit dhe ketij Statuti)

Shoqeria “A.E. DISTRIBUTION” sh.p.k. eshte person juridik. Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne Gjykate.

NENI 4

Shoqeria “A.E. DISTRIBUTION” sh.p.k. krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje kohezgjatje te pa kufizuar



NENI 5

Shoqeria "A. E. DISTRIBUTION" sh.p.k. per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet, pergjigjet vetem me pasurite e saj. Ortaku i kesaj shoqerie pergjigjen per detyrimet e shoqerise deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

NENI 6

Shoqeria "A. E. DISTRIBUTION" sh.p.k. do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

"Import - eksport te te gjitha llojeve te mallrave, tregtimin me shumice e pakice te mallrave ushqimor, elektronik, veshje, mobilje etj, menaxhimin e bar - restoranteve, hoteleve, serviseve.

K R E U II

MARREDHENIET EKONOMIKO - FINANCVIARE

NENI 7

Kapitali themeltar I shoqerise . eshte 100.000 leke
Kapitali zoterohet nga ortaku I vetem :

GERIAN KUKA 100 %

Kapitali themeltar eshte I ndare ne 100 pjese te barabarta, secila me vler nominale 1000 leke

Kapitali themeltar eshte ngurtesuar ne banke teresishte ne momentin e themelimit te shoqerise

Kapitali themeltar apo pjese te caktuara te tij jane te transferusheme perkundrejt personave te trete. Transferimi I kapitalit ose pjeseve te tij ne favore te nje personi te trete behet gjithmone ne perputheje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me akt noterial.

Vleresimi I kapitalit themeltar ne natyre behet nga nje ekspert kompetent I caktuar nga ortaku.

NENI 8

Zmadhimi ose zvogelimi I kapitalit themeltar behet ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi.

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij regjistrohen ne nje regjister te vecante.



NENI

9

Fitimi neto I realizuar nga aktiviteti I shoqerise do ti mbetet ortakut te

vetem.

NENI

10

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdive ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilanci I aktivitetit te shoqerise duhet te perfundoje brenda muajit mars te vitit pasardhes. Rrezultatet e bilancit financiar duhet te behen te njohura ortakut dhe gjithmon rezutati perfundimtar duhet te meret ne shqyrtim nga asambleja e ortakeve, brenda gjashtemuajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI

11

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj, ne perputheje me rregullat ne fuqi. Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre caktohen nga asambleja e ortakeve.

NENI

12

Shoqeria disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

K R E U III

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI

13

Ortaku zoterues 100% kapitalit themeltar ai mere pjese ne administrimin e veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ne perputheje me aktin e themelimit dhe statutin

Kerkoj dhe u jap te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarin e shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria (Bilanci Libra llogarie)

Bej propozime dhe I paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe asamblese se shoqerise

Mund te heq dore nga shoqeria ne kushtet qe percaktohen ne aktin e themelimit

Depozitoj kuoten e tyre ose kuoten suplementare ne perputheje me aktin e themelimit

Marr pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete une

Kryej detyrat e ngarkuara nga Asambleja per realizimin e detyrimeve te shoqerise.





K R E U IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I

SHOQERISE

N E N I 14

Organi me I larte vendimor I Shoqerise eshte Asambleja
 Ne Asamble marrin pjese :ortaku I vetem zoterues I kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise..
 Asambleja vendos per keto probleme:
 Miraton bilancin vjetor te shoqerise
 Vendos per shtimin, paketimin ,ose transferimin e kapitalit themeltar.
 - Emron dhe shkarkon Administratorin e Shoqerise.
 - Ben modifikimin ne aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.
 - Vendos per mbylljen e aktivitetit te shoqerise ose shndrrimi eshoqerise.

Marja e vendimeve te Asamblese eshte e domosdoshme per keto
 Ceshtje :
 Per modifikimin e aktit te themelimit
 - Per rritjen, paksimin ose transferimin e kapitalit themeltar, per mbylljen para afatit te shoqerise.
 Asambleja e ortakeve thirret jo me pak se nje here ne vit.
 Cdo pjese e barabart e kapitalit themeltar jep te drejtan e nje vote ne mbledhjen e asamblese

N E N I 15

Administratori I shoqerise ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise ne mardheniet me persona te trete.
 Administratori nuk mund te kryeje vetem ato detyra qe I jane lene ne kompetence .

Shoqeria mer persiper te gjitha pasojat qe vijne nga veprimet e administratorit

N E N I 16

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te tret, kur gjate veprimtarise se tyre shkelin ligjin, kontraten dhe statutin

Administratore e pare e shoqerise per nje periudhe 3 vjecare emerohet

Z. GERIAN KUKA

NENI

17

Marrdhenjet e punes me punetoret qe do te punesohen ne shoqeri, rregullohen me ane te kontrates individuale , qe lidhet me secilin prej tyre.

Per rregullimin e ketyre mardhenjeve administratori ka te drejt te nxjere rregullore te brendshme ne te cilen eshte I detyruar te zbatoj dispozitat ligjore ne fuqi.

K R E U V

MBYLLJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI

18

Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontrate, nese ortaku, me vullnetin e tij te lire, nuk e zgjat kete afat.

Ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit te parashikuar ne kontrat, kur per kete merr vendim ortaku I vetem. Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur Ai , vendos per shnderimin e shoqerise nga Sh.p.k ne shoqeri te nje lloji tjeter.

NENI

19

Kur shoqeria likujdohet plotesisht, Asambleja krijon komisionin e Likujdimit I cili paraqet bilancin e likujdimit.

Pasuria qe eshte futur ne Shoqeri me te drejte shfrytezimi, I kthehet pronarit te saj

NENI

20

Per gjithhecka nuk eshte shprehur posacerisht ne kete statut I referohet dispozitave te ligjit Nr 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerit tregetare" kreu per shoqerit me pergjegjesi te kufizuar

ORTAKU I VETEM

GERIAN KUKA

Gerian Kuka

[Signature]